

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.H. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale, Shmangia nga tatimi nga neni 249 par.2 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit I.H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.14/2014 datë 29.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 29.03.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit I.H., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.14/2014 datë 29.06.2017, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktgjykimin PKR.nr.14/2014 datë 29.06.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin I.H., për shkak të veprës penale, Shmangia nga tatimi nga neni 249 par.2 të KPK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim me gjobë në shumë prej 5000 euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen me kusht që i akuzuari në afat prej 18 muajve pasi aktgjykimi të merr formën e prerë të mos kryej vepër tjetër penale të natyrës së njëjtë (koha e verifikimit). Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 357.70 euro dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 100 euro, në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit I.H., av. A.I., për shkak të cenimit esencial të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe cenimit të ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe ta ndryshon aktgjykimin e atakuar dhe të akuzuarin I.H. ta liroj nga akuza apo ta anulon dhe lëndën ta kthen në rigjykim

-Përgjigje në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit ka parashtruar Prokuroria Themelore në Ferizaj me propozim që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit I.H. të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.97/2018 të dt. 02.03.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar kurse përgjigja në ankesë e parashtruar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi në ankesën e tij thekson se aktgjykimi i atakuar është i pa bazuar dhe i pa drejtë dhe se cenimi esencial i dispozitave të procedurës penale konsiston në faktin se dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban fakte dhe rrethana që përmbajnë tiparet qenësore të veprës penale (prezantimi i të dhënave të pa vërteta, dashjen dhe qëllimin) për shmangie nga tatimi nga neni 249 par.2 të KPRK-së, dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë dhe i pa kuptuar përkitazi me faktin qenësor, kohën e përcaktuar të shmangies së tatimit të pretenduar duke qenë se sipas ligjit si periudhë tatimore trajtohet viti kalendarik nga 01 Janar deri me 31 Dhjetor të vitit përkatës, ndërsa në dispozitiv të aktgjykimit prezantohet periudha 2009-2012. Është evidente se midis dispozitivit dhe arsyesimit të aktgjykimit dhe përmbajtjes së provës materiale raportit të ekspertizës, përkitazi me të akuzuarin I.H. me shumën e llogaritur në emër të tatimit në të ardhura personale ekziston kundërshtim esencial, i ngarkohet shuma e obligimit tatimor e ortakut e që është në kundërshtim me ligjin mbi shoqatat tregtare dhe ligjin 3/L-161. Aktgjykimi sipas mbrojtjes nuk përmban arsyen për faktet vendimtare dashjen e të akuzuarit dhe qëllimin për të iu shmangur tatimit në kuptimin penal juridik. Gjykata gabimisht ka vërtetuar edhe gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit kur të mbrojturin tim e ka shpallur fajtorë duke qenë se provat e administruara në shqyrtimin kryesor nuk vërtetojnë se i akuzuari I.H. ka prezantuar me qëllim që të shmanget pagesës së tatimit të dhëna të pa vërteta. Përkundrazi kontratën për blerjen e patundshmërisë në vitin 2008 e ka prezantuar dhe vërtetua në Gjykatë, pagesën e ka bërë përmes transferit bankarë dhe në Drejtorin e Kadastrit ka prezantuar kontratën dhe pagesën bankare. Është evidente jo përputhshmëria midis rrethanave të cilat prezanton ATK në raportin final –hetues dhe konstatimet dhe mendimet të ekspertit financiarë si dhe veprimet të cilat i ka zbatuar ATK-ja regjionale në Ferizaj në trajtimin e kësaj çështjeje. Cenimi i ligjit penale në këtë çështje është bërë nga neni 385 par.1 nënpar.1.1 të KPK ku në rastin konkret nuk ka qenë në mënyrë implicite nuk rezulton se te i akuzuari ka ekzistuar dashja, tipare pa të cilat nuk mund të konsumohet vepra penale konkrete.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit I.H. si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palës mbrojtëse si dhe arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit. Kjo gjykatë vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Nga administrimi i provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e të përshkruara në faqen 4, 5, 6 dhe 7 të aktgjykimit të shkallës së parë, pa mëdyshje u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor dhe gjykuar si në aktgjykimin e shkallës së parë. Nga vetë mbrojtja e të akuzuarit nuk është mohuar blerja e ngastrës-palujtshmërisë të cilës ia ka ndryshuar pastaj dedikimin në tokë ndërtimore dhe ua ka shitur blerësve të ndryshëm duke përpiluar kontrata të veçanta dhe duke u kryer pagesat përmes llogarisë së tij personale, kontrata këto që nuk janë kontestuar nga i akuzuari ndërsa mbrojtësi i tij thekson se te i njëjti ka munguar dashja pasi nuk ka ditur se për këto shitblerje duhet të paguhet tatimi dhe kontributet tjera në ATK. Pra nga vetë ky pohim por edhe nga provat tjera shihet se janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 249 par.2 të KPK dhe atë jo për faktin se i njëjti ka deklaruar të dhëna të pa vërteta por për faktin se nuk i ka përfshirë informatat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo faktet tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes lidhur me faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me llogaritje të tatimit edhe për pjesën e E.H., gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se për të ekzistuar ortakria e përgjithshme duhet që e njëjta të jetë themeluar me një akt të veçantë pranë Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve e që në rastin konkret një akt i tillë mungon si dhe fakti se të gjitha pagesat për shitjen e parcelave në bazë të kontratave mbi shitblerjen janë paguar në llogarinë bankare personale të akuzuarit I.H..

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Sa i përket vendimit mbi dënim aktgjykimi i shkallës së parë në këtë drejtim nuk është atakuar mirëpo gjykata e shkallës së dytë duke vepruar sipas detyrës zyrtare të njëjtën e shqyrtoi edhe në këtë pjesë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.98/2018, më 29.03.2018

Procesmbajtëse,

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja

Leonita Lajçi

1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala _____